

V E N D I M
Nr. 129, datë 16.2.1998

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT ADMINISTRATIV TË
PREFEKTURËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 7608, datë 22.9.1992 "Për prefekturat", ndryshuar me ligjin nr.8209, datë 22.4.1997, me propozimin e Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, Këshilli Ministrave

V E N D O S I :

1. Në çdo prefekturë, me vendim të prefektit, krijohen si organ këshillimor këshilli administrativ i prefekturës, i cili përbëhet nga:

- prefekti;
- sekretari i përgjithshëm i prefekturës;
- kryetarët e këshillave të rretheve dhe kryetarët e bashkive në juridiksion të prefekturës;
- drejtori i policisë së prefekturës;
- komandantët e njësive të mëdha ushtarake në prefekturë;
- shefi i qendrës së mobilizimit;
- drejtorët e drejtorive të bujqësisë dhe ushqimit, të arsimit dhe shëndetit publik;
- shefi i inspektoratit të mbrojtjes së mjedisit në nivel prefekturë;
- kryetarët e degëve të buxhetit, thesarit të tatimtaksave dhe doganave në rrethe;
- përgjegjësi i zyrave të punës dhe çështjeve sociale në rrethe;
- drejtorët e policisë së ndërtimit.

Këshilli administrativ kryesohet nga prefekti.

2. Mbledhjet e këshillit administrativ të bëhen jo më pak se një herë në tre muaj, por këshilli mund të mbledhet edhe më shpesh në varësi nga problemet që dalin dhe kur një gjë e tillë gjykohet e domosdoshme.

3. Mbledhja e këshillit administrativ mund të bëhet edhe me pjesëmarrje të kufizuar, për probleme me karakter të veçantë. Në këtë rast pjesëmarrja përcaktohet nga prefekti.

Prefekti kur e çmon të arsyeshme, mund të ftojë në mbledhjet e këshillit administrativ edhe persona të tjerë të zgjedhur, ose funksionarë të pushtetit lokal e të administratës shtetërore lokale.

4. Mbledhjet e këshillit administrativ bëhen sipas kësaj procedure:

- Njoftimi për mbledhjen e këshillit administrativ bëhet jo më vonë se tri ditë përpara. Pjesëmarrësve u bëhet e ditur rendi i ditës, data dhe ora e saktë e mbledhjes. Përgjithësisht bëhet për mbledhjet e diktuar nga problemet e ngutshme.

- Prefekti parashtron problemet, për të cilat do të diskutohet sipas rendit të ditës me shkrim dhe në raste të veçanta me gojë. Pas diskutimit të problemeve me pjesëmarrësit, prefekti nxjerr përfundime veças për zgjidhjen e çdo problemi të shtruar dhe merr vendimin përkatës.

Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, informohet rregullisht me shkrim për përfundimet e çdo mbledhjeje të këshillit administrativ, sipas informacionit me shkrim të dërguar nga prefekti brenda tri ditëve nga dita e zhvillimit të mbledhjes.

Anëtarët e këshillit i përgjigjen prefektit për kërkesat që ai u parashtron dhe kanë të drejtë të bëjnë sugjerimet përkatëse me shkrim ose me gojë.

5. Në mbledhjet e këshillit administrativ të prefekturës shqyrtohen probleme të rëndësishme si:

- përgatitja e programit vjetor të prefekturës;
- probleme të zhvillimit ekonomik-shoqëror të prefekturës;
- probleme që lidhen me sigurimin e rendit e të qetësisë publike të prefekturës;
- probleme të bashkërendimit të punës mes institucioneve të veçanta e të administratës shtetërore në nivel lokal, si dhe këtyre institucioneve me organet e zgjedhura të pushtetit lokal të prefekturës;
- probleme që lidhen me ruajtjen dhe sigurimin e shëndetit publik dhe ruajtjen e mjedisit të

prefekturës;

zbatimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga organet e pushtetit lokal dhe administrata e tyre;

masat që merren nga institucionet buxhetore për zbatimin e buxhetit dhe miradministrimin e burimeve ekonomiko-kulturore, natyrore e historike;

bashkërendimin e punës mes komandave ushtarake dhe institucioneve e organeve civile për plotësimin e detyrave në fushën e mbrojtjes, në përputhje me ligjet, vendimet e Këshillit të Mbrojtjes e të Këshillit të Ministrave;

masat mbrojtëse ndaj fatkeqësive natyrore;

zbatimi i detyrimeve të shtetasve për mobilizimin ushtarak, si dhe për çdo problem tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me ushtrimin e kompetencave dhe detyrave që ligji i ka ngarkuar prefektit.

6. Problemet e shqyrtuara në mbledhjen e këshillit administrativ, u dërgohen organeve dhe institucioneve të interesuara për ndjekjen e tyre.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen prefektët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano